



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 738/11 Prot.

Tiranë, më 19. 11.2024

V E N D I M

Nr. 284, datë 19 . 11. 2024

Mbështetur në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi² është regjistruar ankesa nr. 101 Regj., datë 14.05.2024, e Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare³, përfaqësuar nga z.Y. B, Kryetar kundër Postës Shqiptare sh.a, me pretendimin për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, pala ankuese pretendon se: *Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare është një organizatë sindikale e regjistruar në përputhje me ligjin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas Vendimit nr. 1749, datë 06.03.2015. Sindikata prej vitesh ushtron aktivitetin e saj në Postën Shqiptare sh.a. dhe ka lidhur kontrata kolektive, ndërsa e fundit ka përfunduar më datë 07.07.2021. Nga ana e Sindikatës janë bërë kërkesa të vazhdueshme për lidhjen e kontratës së re kolektive. Gjatë zhvillimit të procedurave për lidhjen e marrëveshjes kolektive me Postën Shqiptare sh.a., është vërejtur zvarritje e qëllimshme e këtij procesi.*

¹ Në vijim do t'i referohe, ti me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Në vijim do ti referohemi SPPSH.

Nga ana jonë, kërkojmë ndërmjetësimin e Komisionerit, pasi në shkresën e dërguar më datë 27.04.2024, ndër të tjera, thuhej: "Bazuar në nenin 164 të Kodit të Punës, ju keni sjellë vërtetim për periudhën 2019-2021, ndërkohë që Kodi përcakton se duhet të jetë për dy vitet e fundit."

Sindikata kundërshton me forcë këtë argument, pasi afatet ligjore i ka tejkaluar Posta Shqiptare sh.a., duke qenë se ne kemi dy vite që kërkojmë lidhjen e kontratës, dhe kërkesa e parë është bërë më datë 09.07.2021, më pas më 13.07.2022 dhe 03.05.2023. Kërkesat tona për takim nuk janë marrë parasysh dhe as na është kthyer përgjigje përmes telefonit. Pas ndërmjetësimit të Inspektoratit të Punës, procedurat u rihapën pas gati një viti, por, përmes makinacioneve, u anuluan dhe rihapën sërish. Në ballafaqimin e fundit, pala tjetër dispononte vetëm lista me emra dhe firma, pa ndonjë dokumentacion tjetër të nevojshëm. Nuk u paraqitën deklarata noteriale për secilin punonjës dhe kuotizacioni, çka duhej ta skualifikonte. Posta heshti për këtë vendim të Komisionit të Pajtimit.

Ne u detyruam t'i shkruanim Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, i cili, përmes shkresës nr. 7656 prot., datë 26.04.2023 të Sekretares së Përgjithshme, e urdhëroi Postën që të ulëj dhe të zbatonte nenin 164 të Kodit të Punës, si dhe të shpallte rezultatet sipas provës së përfaqësueshmërisë. Posta vazhdoi të heshtë, duke i dhënë mundësi palës tjetër të plotësonte dokumentacionin dhe të kalonin afatet për ne. Ne kundërshtojmë me forcë dokumentacionin e servirur nga Posta Shqiptare sh.a. dhe kërkojmë ballafaqim në zyrën tuaj, si dhe dorëzimin e dokumentacionit nga sindikata tjetër për të parë ndryshimet.

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit nga ana e Postës Shqiptare sh.a., rivendosjen e të drejtave të shkelura, pagesën e dëmit ekonomik për dy vite dhe nënshkrimin sa më parë të kontratës kolektive.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të LMD-së, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet : "1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me

banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, shkronja b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:*

.....
b) legjitimitimin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative.”

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet : *“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.....”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.*

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“7. “Palë” është: a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi; ose b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. 8. Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se: *“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person: a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative; b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t’i drejtohet vendimi i procedurës administrative; ose c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”*

Referuar Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me nr. 1749, datë 06.03.2015, nëpërmjet së cilit Sindikata e Punonjësve të Posta Shqiptare, është regjistruar si person juridik, si dhe Statutit të saj, konstatohet se qëllimi dhe fusha e veprimtarisë së kësaj Sindikate është mbrojtja e drejtpërdrejtë e të drejtave ligjore në punë, interesave ekonomike e shëndetësore të punonjësve, duke u bazuar në Kushtetutë dhe me mjete ligjore demokratike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, me numër të identifikimit të subjektit (NUIS) J61924007N, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*, të ndryshuar, me aksioner të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.⁴ Objekti i aktivitetit të Postës Shqiptare sh.a. është: *“Shërbime postare, financiare dhe bankare, aktiviteti i gjithë shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, botimi i gazetës "Postieri", aktivitet radiofonik ("Radio Posta"), veprimtari biznesi, etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Agjent në tregun e sigurimeve. Institucion i parasë elektronike.”*

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, SPPSH, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, pasi rezulton se të drejtat dhe interesat legjitime të palës ankuese çenohen nga procedura për përzgjedhjen e Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës, e cila zhvillohet nga punëdhënësi Posta Shqiptare sh.a. Posta Shqiptare sh.a gjithashtu legjitimohet si subjekt kundër të cilit është paraqitur ankesa, pasi është në cilësinë e palës/punëdhënësit i cili zhvillon procedurën për përzgjedhjen e Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës.

Referuar nenit 33, të LMD, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj për pranimin e saj dhe shqyrtimin në themel të pretendimeve të parashtruara nga pala ankuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 738/1/2 prot., datë 22.05.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, por dhe nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në cilësinë e aksionarit, me anë të cilës ka kërkuar si më poshtë:

Nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a:

⁴ Referuar ekstraktit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB): www.qkb.gov.al.

- Informacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit.
- Informacion në lidhje me qëndrimin e Posta Shqiptare sh.a, mbi kërkesat e bëra nga Sindikata pas përfundimit të kontratës kolektive.
- Informacion të detajuar që nga shpallja e procedurës për lidhjen e kontratës kolektive, procedura e plotë, numrin e kërkesave dhe vendimi përfundimtar. (*dosja e plotë shkresore*)
- Kopje të dokumentacionit të paraqitur nga secila palë në këtë proces.
- Informacion në lidhje me procedimin penal nr. 5053 datë 21.10.2022.

Nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit:

- Informacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit.
- Informacion në lidhje me qëndrimin tuaj në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a, mbi kërkesat e bëra nga Sindikata.
- Informacion mbi masat e ndërmarra nga ana e aksionarit për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikës së parashtruar nga ankuesi.

2. Me shkresën nr.732/2 prot., date 03.06.2024, është administruar pranë Komisionerit, kërkesa nr.92 prot., datë 31.05.2024 e SPPSH-së, me anë të cilës ka kërkuar që nga ana e Komisionerit të merren masat si më poshtë: *“Ti kërkohej noterës M. D, që të dorëzojë pranë Komisionerit të gjitha të dhënat e detajuara të FSPTTSH. Kemi dyshuar dhe kjo po vërtetohet se anëtarësimi i çdo anëtari të sindikatës duhet të jetë para noterit me deklaratë personale dhe e dyta kuotizacioni i derdhur në KSSH është për llogari për të gjithë dhe jo e specifikuar për sindikatën në fjalë. Këto manovra KSSH i ka si "praktikë pune" që mund t'ia hedhë institucioneve si në rastin e Posta Shqiptare sh.a. Nga verifikimet në terren nga ana jonë asnjë punonjës që paraqitet në lista ska paguar kuota, pra kuotizacioni është fiktiv. Kërkesa nga ana juaj e këtyre detajeve do të verifikojë falsifikimin e dokumentacionit. Posta heq përgjegjësinë duke thënë se kjo i mbetet në përgjegjësi FSPTTSH.”*

3. Me shkresën nr. 1079/1 prot., datë 04.06.2024⁵ të Shoqërisë Posta Shqiptare, është përcjellë pranë Komisionerit informacioni i kërkuar, në lidhje me ankesën, duke informuar se:

“Grupi i punës, ngritur me Urdhër të Brendshëm Nr.78, datë 26.05.2022, mbështetur në nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 159 e vijues të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë" (i ndryshuar), në mënyrë që punonjësit të mund të mbrojnë të drejtat, interesat ekonomike, profesionale dhe sociale të tyre, lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës dhe ushtrimin e veprimtarisë sindikaliste, filloi procedurat për përzgjedhjen e Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës.

Për sa më sipër, me qëllim ndalimin e diskriminimit padrejtësisht, sigurimin e besimit dhe transparencës për këtë procedurë, si dhe trajtimin e barabartë të të gjithë organizatave sindikale që mund të shprehin interes për lidhjen e marrëveshjes kolektive të punës me Shoqërinë “Posta

⁵ Administruar pranë Komisionerit me nr.738/3 prot., datë 05.06.2024.

Shqiptare" sh.a., Grupi i Punës me relacionin nr. 1284/1prot., datë 06.06.2022, i propozoi Administratorit të Shoqërisë, publikimin e një njoftimi për pjesëmarrje në Faqen Zyrtare të Posta Shqiptare sh.a., në adresën <http://www.postashqiptare.al/> si dhe në "Posta Shqiptare-Faqja Zyrtare" në rrjetin social Facebook.

Nëpërmjet njoftimit, Sindikatave, i'u kërkua të depozitonin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në adresën: Rruga "Reshit Çollaku", Nr. 4, Tiranë (Zyra e Protokollit), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit (publikimi u realizua më datë 07.06.2022-17.06.2022), dokumentacionin e mëposhtëm: 1- Kërkesën me shkrim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive; 2- Statutin e Sindikatës; 3- Treguesit mbi përfaqësueshmërinë.

Kjo bazuar në nenin 163, pika 3 e K.P. R.SH "Kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive bëhet me shkrim. Ajo shoqërohet me kopjen e statutit të organizatës ose organizatave kërkuese sindikale, si dhe me treguesit e nevojshëm mbi përfaqësueshmërinë e këtyre të fundit në ndërmarrje, ndërmarrjet ose degën e caktuar".

Për sa më sipër, pas verifikimeve të bëra pranë zyrës së Protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare sh.a., rezultoi të ishin depozituar dhe protokolluar 2 (dy) kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës me Shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a. e konkretisht nga:

1- Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare shoqëruar me:

- *Kërkesën nr. 25 prot., datë 10.06.2022, protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a. me nr. 1284/3 prot., datë 10.06.2022;*
- *Vendimin nr. 6, datë 02.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ; Statusi dhe ndryshimet statutores;*
- *Vërtetim noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021 mbi treguesit e përfaqësueshmërisë.*

2- Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, shoqëruar me:

- *Kërkesën nr. 11 prot., datë 16.06.2022, protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a. me nr. 1284/4 prot., datë 17.06.2022;*
- *Vendimin nr. 15, datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Statutin e Sindikatës;*
- *Deklarata anëtarësimi.*

(Kjo ka qenë faza fillestare e procedurës, fazat e tjera janë pezulluar për shkak të kërkesës nr. 1 1500/1, datë 20.06.2022 nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, si pasojë e ankesës nga

Sindikata e Pavarur e Industrisë, Energjitikës dhe Security të Shqipërisë drejtuar dhe Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë).

Në kërkesën e saj, kjo e fundit kërkon që çështja e ngritur në ankesë të trajtohet në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë dhe më pas të informohet Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve. Nga komunikimi elektronik me Kryetarin e Këshillit, rezulton se qëndrimi i mbajtur nga ana e Posta Shqiptare sh.a. ka qenë korrekt.

Në mbledhjen e datës 09.08.2022 të Këshillit Mbikëqyrës është trajtuar çështja e ankesës referuar dhe relacionit të Drejtorisë Juridike me nr. 1826 prot, datë 04.08.2022, nga ku është vendosur vijimi i procedurave të përzgjedhjes së sindikatës.

Gjithashtu është informuar dhe Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve me shkresën nr. 1826 prot., datë 04.08.2022. Më tej, bazuar në nenin 163 pika 4 Kodin e Punës "Punëdhënësi", të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar, në mënyrë të dukshme, gjatë dy javëve, në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët u procedua me publikimin e kërkesave duke i afishuar në vende të dukshme, në ambientet e Drejtorisë së Filialeve/Degëve dhe Zyrave Postare, si dhe iu komunikua të gjithë Drejtorëve të Filialeve të "Posta Shqiptare" sh.a detyrimi i afishimit të tyre duke filluar nga data 19.09.2022 deri më 03.10.2022, në vende të dukshme në ambientet e Zyrave Postare. Pas përfundimit të afatit 2 (dy) javor, Grupi i Punës, u mblodh me qëllim verifikimin e dokumentacionit të sjellë prej Sindikatave së sipërcituara.

Kjo ka qenë faza përmbyllëse e procedurës, por për arsye të fillimit të procedimit penal nr. 5053 datë 01.07.2022, njoftuar më datë 21.10.2022, Grupi i Punës i propozoi Administratorit pezullimin përkohësisht të procedurës së nënshkrimit të marrëveshjes kolektive të punës, deri në përfundim të shqyrtimit të kallëzimit penal ngritur nga Sindikata e Pavarur e Industrisë, Energjitikës dhe Security të Shqipërisë.

Për këtë vendimmarrje, të dyja Sindikatat kanë vënë në lëvizje Zyrën e Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit. Gjatë seancës u mor vendimi për vijimin e procedurës së përzgjedhjes së Sindikatës më të përfaqësuar duke qenë se procedimi penal i nisur nuk lidhet me çështjen objekt shqyrtimi. Me shkresën nr. 7656 prot., datë 26.04.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Posta Shqiptare dhe dy Sindikatat ankuese, janë lajmëruar mbi procesverbalin e Zyrës së Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit, dhe nga ku në zbatim të nenit 164 të Kodit të Punës, "Posta Shqiptare" sh.a. duhet të shpallë rezultatin sipas provës së përfaqësueshmërisë të paraqitur nga të dyja Sindikatat, me qëllim uljen e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës.

Neni 164 citojmë "...çdo organizatë sindikale e interesuar duhet t'i dorëzojë punëdhënësit ose organizatës së punëdhënësve, me shpenzimet e veta, provën e përfaqësueshmërisë, ku noteri vërteton

numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë”.

Gjithashtu bazuar në Kodin e Punës, citojmë: “Nëse disa organizata sindikale paraqiten së bashku, vlerësohet më i përfaqësuar grupi i organizatave që ka numrin më të madh të anëtarëve” dhe nga ku prej verifikimit të dokumentacionit prej sindikatave rezultoi se: Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare me Vërtetim noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021 vërteton kundrejt dokumentacionit për 1470 anëtar ndërsa Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë nëpërmjet deklaratave të anëtarësimit vërteton për 1341 anëtar nënshkrues.

Në këto kushte, grupi i punës konstatoi se numri i anëtarëve i cili është paraqitur nga pjesëmarrësit e përfaqësuesve sindikalistë ka mospërputhje, për shkak se një shoqëri si Posta Shqiptare me rreth 2500 punonjës, u paraqit SPPSH e cila pretendon për 1470 anëtar dhe FSPTTSH me pretendimin për 1341 anëtar, rezulton që një punonjës poste të përfaqësohet në më shumë se dy sindikata.

Për sa më sipër, Grupi i Punës ka kërkuar prej Sindikatave paraqitjen e vërtetimit mbi përfaqësueshmërisë, konform citimit të Zyrës së Ndërmjetësimit dhe të Pajtitimit, duke iu referuar nenit 164 të KP, me qëllim marrjen e një vendimi, por asnjë prej palëve nuk depozitoi asnjë vërtetim.

Gjendur në këto kushte, Posta Shqiptare sh.a. vendosi anulimin e procedurës së përzgjedhjes së Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës.

Grupi i punës, ngritur me Urdhër të Brendshëm Nr.20, datë 07.03.2024, mbështetur në nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 159 e vijues të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë" (i ndryshuar), në mënyrë që punonjësit të mund të mbrojnë të drejtat, interesat ekonomike, profesionale dhe sociale të tyre, lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës dhe ushtrimin e veprimtarisë sindikaliste, filloi procedurat për përzgjedhjen e Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës.

Për sa më sipër, me qëllim ndalimin e diskriminimit padrejtësisht, sigurimin e besimit dhe transparencës për këtë procedurë, si dhe trajtimin e barabartë të të gjithë organizatave sindikale që mund të shprehnin interes për lidhjen e marrëveshjes kolektive të punës me Shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a. Grupi i Punës me relacionin nr. 514/lprot., datë 18.03.2024 i propozoi Administratorit të Shoqërisë, publikimin e një njoftimi për pjesëmarrje në Faqen Zyrtare të Posta Shqiptare sh.a. në adresën <http://www.postashqiptare.al/si> dhe në "Posta Shqiptare-Faqja Zyrtare" në rrjetin social facebook.

Nëpërmjet njoftimit, Sindikatave, i'u kërkuar të depozitonin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në adresën: Rruga "Reshit Çollaku", Nr. 4, Tiranë (Zyra e Protokollit), brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit (publikimi u realizua më datë 18.03.2024 - 31.03.2024) dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën me shkrim për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive;
2. Statutin e Sindikatës;
3. Treguesit mbi përfaqësueshmërinë.

Kjo bazuar në nenin 163, pika 3 e K.P. R.SH "Kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive bëhet me shkrim. Ajo shoqërohet me kopjen e statutit të organizatës ose organizatave kërkuese sindikale, si dhe me treguesit e nevojshëm mbi përfaqësueshmërinë e këtyre të fundit në ndërmarrje, ndërmarrjet ose degën e caktuar.

Për sa më sipër, pas verifikimeve të bëra pranë zyrës së Protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare sh.a., rezultoi të ishin depozituar dhe protokolluar 2 (dy) kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës me Shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a. e konkretisht nga:

1. Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare shoqëruar me:
 - Kërkesën nr. 78 prot., datë 28.03.2024, protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a. me nr. 643 prot., datë 28.03.2024;
 - Vendimin nr. 6, datë 02.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ;
 - Statusi dhe ndryshimet statutore;
 - Vërtetim noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021 mbi treguesit e përfaqësueshmërisë.
 - Vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin nr. rep 2105 datë 25.03.2024 të Vërtetimit noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021.
2. Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, shoqëruar me:
 - Kërkesën nr. 702 prot., datë 08.02.2024, protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a. me nr. 296 prot., datë 09.02.2024;
 - Vendimin nr. 15, datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
 - Statutin e Sindikatës;
 - Vërtetim Noterial datë 07.02.2024 për përfaqësueshmërinë për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Më tej, bazuar në nenin 163 pika 4 e Kodit të Punës "Punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar, në mënyrë të dukshme, gjatë dy javëve, në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët, u procedua me publikimin e kërkesave duke i afishuar në vende të dukshme, në ambientet e Drejtorisë së Filialeve/Degëve dhe Zyrave Postare, si dhe ju komunikua të gjithë Drejtorëve të Filialeve të "Posta Shqiptare" sh.a detyrimi i afishimit të tyre duke filluar nga data 04.04.2024 deri më 18.04.2024, në vende të dukshme në ambientet e Zyrave Postare.

Pas përfundimit të afatit 2 (dy) javor, Grupi i Punës, u mbledh me qëllim verifikimin e dokumentacionit të sjellë prej Sindikatave të sipërcituara, nga ku u konstatua se:

Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare ka depozituar vërtetim noterial, ku noteri ka vërtetuar numrin e anëtarëve të organizatës së punëmarrësve, në bazë të kuotizacioneve të paguara për periudhën 01.08.2019 - 31.07.2021, ndërkohë që neni 164 i Kodit të Punës e kërkon për gjatë dy viteve të fundit. Për sa më sipër, Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare, nuk dëshmon dhe provon numrin e anëtarëve punëmarrës pranë "Posta Shqiptare" sh.a. Kjo Sindikatë ka paraqitur Vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin nr. rep 2105 datë 25.03.2024 të Vërtetimit noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021.

Ndërsa dokumentacioni i Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë është paraqitur në formën e kërkuar konform nenit 163 të Kodit të Punës nga ku dhe vërtetimi noterial, në bazë të kuotizacioneve, parashikon 1400 punonjës të Postës Shqiptare anëtar të kësaj Federate. Pra FSPTTSH vlerësohet si organizata më e përfaqësuar duke qenë se provon nëpërmjet vërtetimit noterial, se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës pranë "Posta Shqiptare" sh.a.

Për sa më sipër, "Posta Shqiptare" sh.a. është në fazën e uljes së bisedimeve mbi kushtet e marrëveshjes kolektive të punës me Federatën e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë.

Nga njoftimi për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës nr. 514/2 prot., datë 18.03.2024 deri në përfundimin e afatit 14 (katërmëdhjetë) ditor, Sindikatave të interesuara ju është lënë mundësia e plotësimit të dokumentacionit shoqërues.

Ajo çka e bënë Sindikatën e Punonjësve të Postës Shqiptare të përjashtuar nga nënshkrimi i marrëveshjes kolektive të punës me "Posta Shqiptare" sh.a. është fakti që në asnjë moment nuk provon përfaqësueshmërinë e saj me punonjës të Postës. Ka depozituar njësim të kopjes me origjinalin e vërtetimit noterial të 2021.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane shprehet se: vlerëson se vendimi i Prokurorisë se Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 28.03.2023 "Për pushimin e procedimit penal për materialin kallëzues Nr. 5053 të vitit 2023, është i bazuar në ligj.

Kjo pasi në rastin konkret, del qartë se prej kallëzuesit nuk është kërkuar në Gjykatë detyrimi i "Posta Shqiptare" sh.a, që të rilidhë kontratën kolektive të punës me këtë sindikatë dhe natyrshëm Gjykata ka zgjidhur pasojat që kanë qenë objekt kerkimi duke mos u shprehur për zgjidhjen e kësaj pasoje për shkakun se për të nuk është bërë kërkesë. Kallëzuesi duhet të përdorë mjetet ligjore duke ju drejtuar Gjykatës për sqarim apo interpretim të vendimit sipas kërkesave të përcaktuara në neni 314 të Kodit të Pr. Civile ku përcaktohet se "Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë ku është i errët dhe e kërkojnë palët". Nisur nga sa më sipër

arrihet në përfundimin se fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale dhe për këtë arsye kjo çështje duhet të pushohet.

Sa më sipër u arsyetua, në analizë dhe të faktit të pretenduar nga kallëzuesi, Gjykata arrin në përfundimin, se me të drejtë Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë bazuar në nenin 290 1, germa “ç” të K. Pr. Penale ka vendosur.

"Mosfillimin e procedimit penal, për pushimin e procedimit penal të regjistruar me nr. 5053 regjistri, të vitit 2022, pasi fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale."

4. Me shkresën nr.6717/1 prot., datë 04.06.2024⁶ të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, është përcjellë pranë Komisionerit informacioni i kërkuar, në lidhje me ankesën, me anë të cilës informojnë se:

"Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë Posta Shqiptare sh.a , bazuar në kërkesat e z. Y. B, për rinovimin e kontratës kolektive të punonjësve, ka pasur një sërë korrespondencash me shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a, duke bërë me dije dhe Sindikatën e punonjësve.

Bazuar në shkresën me nr. hyrës 3082, datë 04.03.2024 të Sindikatës, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me shkresën nr.3082/1 prot., datë 25.03.2024, drejtuar shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a., ka kërkuar zgjidhjen e problematikave lidhur me mospërbushjen e kërkesave të tyre nga administratori i shoqërisë si dhe informacion të detajuar lidhur me arsyet e mos nënshkrimit të kontratës kolektive, gjithashtu dhe mosplotësimin të kërkesave të specifikuara në shkresë.

Në përgjigje të shkresave tona, shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., me shkresat nr.647/1 prot., datë 08.04.2024 dhe nr.868/1 prot., datë 27.05.2024 ka sqaruar procedurën e ndjekur me sindikatat.

Lidhur me Kontratën Kolektive, me urdhër të administratorit të shoqërisë është ngritur një grup pune për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e Sindikatës me qëllim nënshkrimin e marrëveshjes kolektive të punës. Për ndalimin e diskriminimit, sigurimin e besimit dhe transparencës për këtë procedurë, si dhe trajtimin e barabartë të të gjithë organizatave sindikale që mund të shprehin interes për lidhjen e marrëveshjes kolektive të punës, nga shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a, është publikuar një njoftim për pjesëmarrje në faqen zyrtare të "Posta Shqiptare" sh.a., në adresën: <http://www.postashqiptare.al/> si dhe në "Posta Shqiptare-Faqja Zyrtare" si dhe në rrjetin social Facebook.

Sipas informacionit të dhënë nga shoqëria ishin paraqitur dy kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës me shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a., konkretisht nga Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare dhe Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë.

⁶ Administruar pranë Komisionerit me nr.738/4 prot., datë 06.06.2024.

Sipas drejtuesve të postës, Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, është vlerësuar si organizata më e përfaqësuar, pasi provon nëpërmjet vërtetimit noterial, se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës pranë shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a.

Sindikata e Punonjësve ka dërguar edhe një shkresë tjetër në të cilën përmendet sponsorizimi i Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës. Në përgjigje të shkresës, përsëri në cilësinë e Aksionarit të vetëm, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nëpërmjet shkresës nr.4643/1 prot., datë 25.04.2024. ka kërkuar informacion ku të shpjegohet përgjegjësia e drejtuesve të shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a, mbi këtë vendimmarrje.

Administratori i shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a Tiranë, ka sqaruar se kjo është një marrëdhënie midis dy organizatave sindikale të cilat rregullohen me akte ligjore dhe nuk janë në tagrin dhe kompetencën e shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a."

5. Me shkresën nr.99 prot., datë 11.06.2024⁷ SPPSH-së, ka paraqitur prapësimet e saj në lidhje me informacionin e dërguar nga ana e Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, si më poshtë:

"SPPSH siç jeni vënë në dijeni dhe ju, është shqetësuar nga marrëdhënia aspak korrekte dhe në kundërshtim me ligjin nga ana e Posta Shqiptare sh.a, e cila në mungesë të plotë transparence nuk jep informacion nëse ka lidhur apo jo marrëveshjen kolektive me subjekt tjetër sindikal, sepse nga burimet tona jo zyrtare që kemi jemi informuar që ajo ka lidhur marrëveshjen kolektive. Ju lutem që me autoritetin tuaj dhe të institucionit që përfaqësoni, duke qenë se organizata jonë vazhdon të diferencohet dhe diskriminohet na siguroni një informacion. Po ashtu kërkojmë nga ana juaj të bëhet një ballafaqim në ditët në vazhdim me administratën e Posta Shqiptare sh.a. Ja pretendimet tona për këto shkelje të rënda të ligjit, për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës dhe Diskriminimi që i është bërë SPPSH-së nga Posta Shqiptare sh.a dhe Administratori i saj A. D:

Kërkesa e parë nga S.P.P.SH.-ja për rilidhjen (theksojmë se ne kemi patur Kontratë Kolektive të punës me Postën Shqiptare prej vitesh dhe e fundit ishte 2 vjeçare 7.7.2019 deri 6.7.2021) është bërë në datë 10.6.2021 së bashku me dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të ligjit (Kodi Punës). Ashtu si dhe pranon vetë Posta Shqiptare në kthimin e përgjigjes me nr.1079/1 prot., datë 4.6.2024 të shkresës Tuaj me nr.738/1 prot., datë 22.5.2024 paragrafi 6 dhe 7 faqe 2, që S.P.P. SH.-ja ka dorëzuar: 1- Kërkesë nr.25 prot., datë 10.6.2022 protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a me nr.1284/3 prot., datë 10.6.2022; 2- Vendimin nr.6 datë 02.06.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; 3- Statusi dhe ndryshimet statutores; 4- Vërtetimin noterial nr.rep.4535 datë 29.12.2021 "Mbi treguesit e përfaqësueshmërisë".

Dokumente ka dorëzuar dhe Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit shoqëruar me: 1- Kërkesë nr.11 prot., datë 16.6.2022 protokolluar pranë Posta

⁷ Administruar pranë Komisionerit me nr.738/5 prot., datë 12.06.2024

Shqiptare sha me nr. 1284/4 prot., datë 17.6.2022: 2- Vendimin nr.5 datë 22.10.2021 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë; 3- Statutin e Sindikatës; 4- Deklarata anëtarësimi.

Si dhe shihen dokumentet e sindikatës tjetër të favorizuar nga Administratori i Posta Shqiptare sh.a., z. A. D, nuk ka dokument që vërteton se ajo kryen veprimtari sindikale në Posta Shqiptare pasi nuk ka vërtetim noterial të lëshuar nga noteri që vërteton përfaqësueshmërinë dhe as deklarata të anëtarëve të bëra para noterit sipas nenit 164; parashikon se: “Nëse përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave sindikale që kanë kërkuar fillimin e bisedimeve kundërshtohet, çdo organizatë sindikale e interesuar duhet t’i dorëzojë punëdhënësit ose organizatës së punëdhënësve, me shpenzimet e veta, provën e përfaqësueshmërisë. Kjo provë paraqitet në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit ose deklarimeve me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë”.

Posta Shqiptare pas 3 muaj të kërkesave të bëra nga 2 Sindikatat, i publikon ato duke i afishuar në të gjitha Filialet e saj duke filluar 19.9.2022 deri 03.10.2022. Posta Shqiptare edhe pse afishoi kërkesat e Sindikatave ajo pas kalimit afatit të afishimit, nuk shpalli Sindikatën më të përfaqësuar që në këtë rast ishte S.P.P.SH.-ja sepse, kishte Vërtetimin Noterial ku vërtetonte përfaqësueshmërinë e saj nëpërmjet kuotizacioneve të paguara nga anëtarët e sindikatës të ndalura në listëpagesa (bordero) me dakordësinë e anëtarëve dhe me urdhër të financës të Posta Shqiptare (mbështetur në nenin 117 të Kodit të Punës). Ndërsa e s’kualifikoi S.P.P.Sh.-në njëlloj si Sindikatën tjetër që, nuk kishte vërtetim noterial e as deklarata me shkrim apo me gojë si e kërkon neni 164 para Noterit. Pra duke shkelur ligjin favorizoi sindikatën tjetër FSPTTSH-në dhe diskriminoi S.P.P.SH-në.

Nga data 03.10.2022 deri në datë 21.10.2022, me gjithë kërkesën e S.P.P.SH. për tu ulur në bisedime për të lidhur Kontratën Kolektive, kjo bazuar në nenit 165 pika 1 thuhet; “Kur përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave sindikale nuk është kundërshtuar ose kur ajo është njohur në mënyrë përfundimtare, punëdhënësi ose organizata e punëdhënësve duhet të presin palën kërkuese të bisedimeve brenda dy javëve, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të afishimit ose, në rast të kundërshtimi të përfaqësueshmërisë, duke filluar nga data e shpalljes përfundimtare të saj...” bazuar në pikën I të nenit 165 të sipërcituar, Posta Shqiptare duhet të ishte ulur të nënshkruante Kontratën Kolektive me S.P.P.SH.-në, por, Posta Shqiptare zgjodhi përsëri të injoronte kërkesën e S.P.P.SH.-së dhe të shkelte ligjin vetëm që të diskreditonte S.P.P.SH. në dhe të favorizonte FSPTTSH-në, duke anuluar përkohësisht procedurën e nënshkrimit të marrëveshjes kolektive. Preteksti ishte se Posta Shqiptare ishte kallëzuar penalisht nga Sindikata e Pavarur e Industrisë, Energjitikës dhe Security të Shqipërisë, arsye pa arsye, e vetmja arsye ishte sajimi nga Posta Shqiptare i alibive të ndryshme vetëm për të diskriminuar S.P.P.SH-në.

Pas vënies në lëvizje të Zyrës të Ndërmjetësimit dhe të Pajtitimit e cila i rekomandon Postës Shqiptare që në zbatim të nenit 164 të Kodit të Punës Posta Shqiptare Sh.a duhet të shpallë

rezultatit sipas provës të përfaqësueshmërisë të paraqitur nga dy Sindikatat, me qëllim uljen në bisedime për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës.

Por jo, përsëri Posta Shqiptare dhe Administratori i saj z. A. D, vrasin mendjen si të diskriminojnë S.P.P.SH.-në dhe e gjejnë alibinë! Posta Shqiptare dhe Administratori duke i vënë në baraspeshë dokumentet e përfaqësimit të paraqitura nga dy Sindikatat ku: S.P.P.SH.-ja dokumentet i kishte konform kërkesave të ligjit përfshirë Vërtetimin Noterial të përfaqësueshmërisë dhe FSPTTSH-ja që nuk i kishte dokumentin e përfaqësueshmërisë konform ligjit, nuk kishte Vërtetim noterial e as deklarata me shkrim ose me gojë para noterit sipas neni 164 i kodit të Punës.

Posta Shqiptare dhe Administratori saj thonë se sindikatat kanë paraqitur anëtarësi me shumë se numri i përgjithshëm i punonjësve të Postës Shqiptare që ishte 2500 vetë. Dhe konkretisht, S.P.P.SH-ja kishte 1470 anëtarë sipas vërtetimit Noterial dhe FSPTTSH 1341 anëtarë të cilët, sipas S.P.P.SH.-së nuk janë të vërtetuar konform nenit 164 të Kodit të Punës nga Noteri ama janë të vërtetuar nga Administratori z. A. D, për të diskriminuar S.P.P.SH.-në dhe për të favorizuar FSPTTSH-në. Dhe për këtë u ngrit alibia e radhës, nga Posta Shqiptare iu kërkoi Sindikatave dokumentin e përfaqësueshmërisë konform kërkesës të Zyrës të Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit duke ju referuar nenit 164 të KP, me qëllim marrjen e një vendimi nga Posta Shqiptare por, sipas saj asnjëra prej Sindikatave nuk depozitoi asnjë vërtetim. Kjo nuk është e vërtet sepse, SPPSH i ka dërguar shkresë me nr.47 prot., datë 15.06.2023, që dokumentin përfaqësimit e kemi dorëzuar së bashku me kërkesën e datës 10.06.2022.

S.P.P.Sh-ja këtë vërtetim që kërkonte Posta Shqiptare e kishte ballafaquar në Zyrën e Ndërmjetësimit dhe Pajtimit së bashku me dokumentet e paraqitura me kërkesën e saj, gjë që e konfirmon dhe Posta Shqiptare po në përgjigjen e saj për ju faqe 2 paragrafi 5 dhe 6. FSPTTSH-ja nuk kishte vërtetim noterial dhe as deklarata me gojë dhe me shkrim edhe këtë e dinte Posta Shqiptare por qëllimi ishte diskriminimi i S.P.P.SH-së.

Në lidhje me procedurën e ndjekur për lidhjen e Marrëveshjes Kolektive të Punës shpallur në datë 18.03.2023:

Kësaj radhe Posta Shqiptare dhe Administratori i saj z.A. D, menduan se ja hodhën paq S.P.P.SH.-së dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e S.P.P.SH.-së dhe FSPTTSh-së, i cili ka qenë i njëjtë me herën tjetër si në përgjigjen e Posta Shqiptare për ju, faqe 5 paragrafi 5 dhe 6, me një ndryshim që, sipas z. A. D, bën diferencën!

Për z. D. Vërtetimi noterial i S.P.P.SH.-së ka dy probleme që duhet të na i sqaroje z A. D; I ka kaluar afati pasi ishte për vitet 2019-2021, por kishte edhe një "kleçkë " tjetër pasi ishte vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin nr.rep 2205, datë 25.03.2024 të vërtetimit noterial nr.rep.4535 datë 29.12.2021. Për cilën nga këto dy probleme Posta Shqiptare dhe z. A. D, e s'kualifikoi nga gara për Marrëveshjen Kolektive, S.P.P.SH.-në !?

FSPTTSH ka dorëzuar Vërtetimin Noterial, për të cilin vlerësohet si organizata më e përfaqësuar? Për këtë vërtetim noterial (i cili duhet dhe është për tu hetuar nga ju (dhe organet e tjera të shteti shqiptar) që është marrë në konsideratë nga Posta Shqiptare kemi disa pyetje dhe kundërshti për grupin e punës dhe Administratorin e Posta Shqiptare.

1. *A e ka parë Posta Shqiptare, zyra juridike dhe grup i punës i ngritur për verifikim dokumentacionin?*
2. *A e pa ky grup që, baza ligjore ku është mbështetur noteri për lëshimin e vërtetimit noterial?*
3. *A përbëjnë bazë ligjore statutet e Konfederatës të Sindikatave të Shqipërisë dhe FSPTTSH?*
4. *Po vendimet e asamblesë të përgjithshme të KSSH, përbëjnë bazë ligjore për këtë grup pune?*
5. *Po neni 117 i Kodit të Punës që bën fjalë për ndaljen e kuotave të anëtarëve të sindikatës, a bëri verifikim ky grup në Postën Shqiptare dhe Filialet e saj nëse ka patur ndalim të kuotës sindikale nga paga në listpagën e punonjësve, ky ndalim bëhet me urdhër të brendshëm, a ka pasur një të tillë?*
6. *Po neni 177 i Kodit të Punës që bën fjalë për Statutin e Sindikatave çfarë ka vërtetuar për kuotat e anëtarëve për grupin e punës?*

Ne kundërshtojmë vendimin e Posta Shqiptare sh.a për s'kualifikimin e S.P.P.SH.-së që, sipas saj i ka kaluar afati vërtetimit noterial të përfaqësimit pasi, duhet për dy vitet e fundit po kur ishte brenda afatit, Posta Shqiptare dhe grupi punës bashkë me z A. D, Administrator pse e s'kualifikuan S.P.P.SH. në?

Po vërtetimi Noterial i cili është shumë i dyshimte për bazën ligjore ku është mbështetur ka edhe një defekt tjetër pasi sipas nenit 164 K.P për përfaqësueshmërinë kuotizacioni duhet të jetë paguar për dy vjetët e fundit e jo për një?

Në lidhje me pikën C të shkresës për ju. Informacion nëse S.P.P.SH.-së i është dhënë koha e duhur për plotësimin e të metave të konstatuara gjatë procesit të verifikimit të dokumentacionit.

Sipas Postës Shqiptare ajo që ka përjashtuar S.P.P.SH-në nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kolektive të Punës është se S.P.P.SH.-ja në asnjë moment (e theksojmë në asnjë moment) nuk provon përfaqësueshmërinë e saj me punonjësit e Postës sepse ka depozituar njësim e kopjes me origjinalin e vërtetimit të noterit 2021, shkresa për ju faqe 6 paragrafi fundit dhe faqe 7. Në lidhje me këtë ne pretendojmë dhe pyesim nëpërmjet jush z. D: Një dokument e humbet vlerën kur është njësim i kopjes me origjinalin e vërtetimit të noterit e vërtetuar po nga noteri? Po të kishit vërtetimin (të cilin e kemi lëshuar në fillim) origjinal të noterit a do ta s'kualifikonit S.P.P.SH. në? Në lidhje me germën D.

Ne e kemi kundërshtuar në kohë që ai kallëzim penal nuk përbënte pengesë për lidhjen e kontratës të re por kallëzimi u përdor si alibi për të zvarritur dhe shtyrë sa më gjatë në kohë lidhjen e marrëveshjes kolektive, për ti dhënë mundësi Sindikatës tjetër FSPTTSH-së për të manipuluar dokumentet e saj dhe për të përdorur argumentin e pa bazuar për kalimin e afatit të vërtetimit noterial të S.P.P.SH-së . Veç pretendimeve tona sa thamë më lart të bazuara në shkresën përgjigje nga Posta Shqiptare për ju, duam t'ju vëmë në dijeni se diskriminimi i S.P.P.SH. ka filluar më herët.

S.P.P.SH. i ka bërë kërkesë Postës Shqiptare për lidhje e marrëveshjes kolektive me datën 09.07.2021 por, për arsye të dorëheqjes të ish- Administratorit z. L. D, dhe emërimin e përkohshëm të disa Administratorëve, ajo kërkesë nuk u mor në konsideratë. Ne mendojmë se institucionet funksionojnë edhe nëse jep dorëheqjen drejtuesi dhe komandohet drejtues i përkohshëm. Pas shumë përpjekje dhe kërkesa nga S P P SH.-ja u arrit të hapej procedura në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2022. Jemi në dispozicion dhe kërkojmë ballafaqim tek ju me Postën Shqiptare.

6. Komisioneri me shkresën nr. 738/6 prot., datë 13.06.2024, kërkoj informacion shtesë nga Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, si më poshtë: “Kërkojmë të na informoni nëse nga ana juaj është lidhur kontrata kolektive me një sindikatë tjetër, nëse po të na vihet në dispozicion informacioni i detajuar që nga shpallja e procedurës për lidhjen e kontratës kolektive, procedura e plotë, numrin e kërkesave dhe vendimi përfundimtar. (dosja e plotë shkresore) Gjithashtu të merren masa për sqarimin e pretendimeve të ngritura nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare, në shkresën nr.99, datë 11.06.2024, të cilin po jua përcjellim bashkëlidhur kësaj shkrese.”

7. Me shkresën nr. 1079/3 prot., datë 21.06.2024⁸, Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, ka kthyer përgjigje në lidhje me sa u kërkuar nga ana e Komisionerit me shkresën nr. 738/6 prot., datë 13.06.2024, ku informon se: “Me shkresën Nr. 1079/1 Prot., datë 04.06.2024 dërguar nga "Posta Shqiptare" sh.a. është përcjellë i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i dosjes mbi procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e sindikatës me qëllim nënshkrimin e marrëveshjes kolektive të punës.

Sindikata e Punonjësve të “Posta Shqiptare” sh.a. nëpërmjet shkresës Nr. 99 Prot., datë 11.06.2024 ka informuar gabim "Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi" se Shoqëria Posta Shqiptare ka lidhur kontratë kolektive me një sindikatë tjetër. Në këto kushte përveç dokumentacionit të dërguar me datë 04.06.2024, "Posta Shqiptare" sh.a. nuk administron dokumentacion tjetër.

Theksojmë për të disatën herë që fazat e përzgjedhjes së Sindikatës kanë mbetur të pezulluara për shkak të Kërkesës Nr. 11500/1, datë 20.06.2022 nga "Ministria e Financës dhe Ekonomisë", si pasojë e ankesës nga "Sindikata e Pavarur e Industrisë, Energjetikës dhe Security të Shqipërisë" drejtuar dhe “Ministrit të Financës dhe Ekonomisë”. Posta Shqiptare funksionon në bazë të “Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe çdo kërkesë e Këshillit Mbikëqyrës duhet të parashtrahet si çështje në rendin e ditës së mbledhjes së përcaktuar. Në kërkesën e saj kjo e fundit kërkon që çështja e ngritur në ankesë të trajtohet në mbledhjen e “Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë” dhe më pas të informohet "Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve". Nga komunikimi elektronik me "Kryetarin e Këshillit, rezulton se qëndrimi i mbajtur nga ana e Posta Shqiptare sh.a. ka qenë korrekt. Në mbledhjen e datës 09.08.2022 të "Këshillit Mbikëqyrës" është trajtuar çështja e ankesës referuar dhe relacionit të Drejtorisë Juridike me Nr.1826 Prot, datë 04.08.2022, nga ku është vendosur vijimi i procedurave të përzgjedhjes së sindikatës.

⁸ Administruar pranë Komisionerit me nr.738/7 prot., datë 24.06.2024

Gjithashtu është informuar dhe "Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve" me shkresën Nr. 1826 Prot., datë 04.08.2022.

Më tej, bazuar në nenin 163 pika 4 Kodin e Punës "Punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar, në mënyrë të dukshme, gjatë dyjavëve, në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët. U procedua me publikimin e kërkesave duke i afishuar në vende të dukshme, në ambientet e Drejtorisë së Filialeve/Degëve dhe Zyrave Postare, si dhe ju komunikua të gjithë Drejtorëve të Filialeve të "Posta Shqiptare" sh.a detyrimi i afishimit të tyre duke filluar nga data 19.09.2022 deri më 03.10.2022, në vende të dukshme në ambientet e Zyrave Postare. Pas përfundimit të afatit 2 (dy) javor, Grupi i Punës, u mbledh me qëllim verifikimin e dokumentacionit të sjellë prej Sindikatave të sipërcituara.

Kjo ka qenë faza përmbyllëse e procedurës, por për arsye të fillimit të procedimit penal Nr. 5053 datë 01.07.2022, njoftuar më datë 21.10.2022, Grupi i Punës i propozoi Administratorit pezullimin përkohësisht të procedurës së nënshkrimit të marrëveshjes kolektive të punës, deri në përfundim të shqyrtimit të kallëzimit penal ngritur nga "Sindikata e Pavarur e Industrisë, Energjitikës dhe Security të Shqipërisë". Kurrsesi nuk ka qenë orvatje, sikurse pretendohet prej SPPSH. por respektim i vendimarrjeve të organeve kompetente. Për këtë vendimarrje, të dyja Sindikatat kanë vënë në lëvizje Zyrën e Ndërmjetësimit dhe të Pajtitimit.

Gjatë seancës u mor vendimi për vijimin e procedurës së përzgjedhjes së Sindikatës të përfaqësuar duke qenë se procedimi penal i nisur nuk lidhet me çështjen objekt shqyrtimi. Me shkresën Nr. 7656 Prot.. datë 26.04.2023 të "Ministrit të Financave dhe Ekonomisë", "Posta Shqiptare" dhe dy sindikatat ankuese, janë lajmëruar mbi procesverbalin e Zyrës së Ndërmjetësimit dhe të Pajtitimit, dhe nga ku në zbatim të nenit 164 të Kodit të Punës "Posta Shqiptare" sh.a. duhet të shpall rezultatin sipas provës së përfaqësueshmërisë të paraqitur nga të dyja Sindikatat. me qëllim uljen e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës. Pra. Zyra e Ndërmjetësimit dhe e Pajtitimit, nuk shprehen se cila është sindikata më e përfaqësuar. Neni 164 citojmë: "...çdo organizatë sindikale e interesuar duhet t'i dorëzojë punëdhënësit ose organizatës së punëdhënësve, me shpenzimet e veta, provën e përfaqësueshmërisë, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy viteve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të anëtarëve të punësuar".

Gjithashtu bazuar në Kodin e Punës, citojmë se: "Nëse disa organizata sindikale paraqiten së bashku, vlerësohet më i përfaqësuar grupi i organizatave që ka numrin më të madh të anëtarëve" dhe nga ku prej verifikimit të dokumentacionit prej sindikatave rezultoi se: Sindikata e Punonjësve të "Postës Shqiptare" me Vërtetimin Noterial Nr. Rep. 4535, datë 29.12.2021 vërteton kundrejt dokumentacionit për 1.470 anëtar ndërsa Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë nëpërmjet deklaratave të anëtarësimit vërteton për 1.341 anëtar nënshkrues.

Në këto kushte, grupi i punës konstatoi se numri i anëtarëve i cili është paraqitur nga pjesëmarrësit e përfaqësuesve sindikalistë ka mospërputhje, për shkak se një shoqëri si "Posta Shqiptare" me rreth 2,500 punonjës, u paraqit SPPSH e cila pretendon për 1,470 anëtar dhe FSPTTSH me pretendimin për 1,341 anëtar, rezulton që një punonjës poste të përfaqësohet në më shumë se dy sindikata. Për sa më sipër, Grupi i Punës ka kërkuar prej Sindikatave paraqitjen e vërtetimit mbi përfaqësueshmërinë, konform citimit të Zyrës së Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit, duke iu referuar nenit 164 të KP, me qëllim marrjen e një vendimi, por asnjë prej palëve nuk depozitoi asnjë vërtetim, përfshi këtu edhe Sindikatën ankuese pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjendur në këto kushte, "Posta Shqiptare" sh.a. vendosi anulimin e procedurës së përzgjedhjes së Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës. Ritheksojmë gjithashtu se për vitin 2024 është proceduar nga fillimi dhe rezultoi se: Ajo çka e bën Sindikatën e Punonjësve të Postës Shqiptare të përjashtuar nga nënshkrimi i marrëveshjes kolektive të punës me "Posta Shqiptare" sh.a. është fakti që në asnjë moment nuk provon përfaqësueshmërinë e saj me punonjës të Postës. Ka depozituar njësim të kopjes me origjinalin e vërtetimit noterial të 2021, jo tregues mbi përfaqësueshmërinë. Kjo e fundit paraqitet në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës së punëmarrësve në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy viteve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtar. Dhe jo në formën e njehsimit të kopjes së vitit 2021 të lëshuar nga noteri.

Çdo dokumentacion i depozituar nga dy Sindikatat pjesëmarrëse është administruar/verifikuar me shumë vëmendje nga "Posta Shqiptare" sh.a. dhe çdo vendimmarrje është marrë bazuar në respektim të dispozitave ligjore të K.P.R.SH."

8. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"⁹, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri pasi vlerësoi kërkesën e palës ankuese, caktoi datën 15.07.2024 ora 10.00 për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr.738/8 prot., datë 08.07.2024.

Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e palës ankuese, e cila u përfaqësuar nga Kryetari i Sindikatës z.Y. B, si dhe anëtarët e kësaj Sindikate z. N. S, z. M. Ç, znj.S. N, ndërkohë pala kundër të cilës është bërë ankesa u përfaqësuar nga z. G. Xh, znj. N. S. dhe znj. J. K, sipas Autorizimit nr.1424/1 prot., datë 15.07.2024.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me Komisionerin.

⁹ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi": "Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar."

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre*”.

LMD, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës Nr. 101, datë 16.05.2024, Komisioneri jep vlerësimin dhe gjykimin e tij, vetëm për ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që këtij institucioni, i atribuohen nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

A. 1 Lidhur me pretendimin e subjektit ankues, për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Mbështetur në provat e administruara, rezulton se Sindikata e Punonjësve të Posta Shqiptare, ka patur të lidhur një Kontratë Kolektive Pune me Shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, e cila ka mbaruar në datën 07.07.2021. Pas përfundimit të kësaj kontrate, me kërkesën nr.18 prot., datë 09.07.2021, SPPSH i është drejtuar Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a për rilidhjen e Kontratës Kolektive të punës.

Në bazë të Urdhrit të Brendshëm nr.78, datë 26.05.2022 të Administratorit të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, është ngritur grupi i punës për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës. Grupi i Punës me Relacionin nr.1284/1

prot., datë 06.06.2022, i ka propozuar Administratorit të Shoqërisë, publikimin e një njoftimi për pjesëmarrje në Faqen Zyrtare të Posta Shqiptare sh.a në adresën: <http://www.postashqiptare.al/> si dhe në “Posta Shqiptare-Faqja Zyrtare” në rrjetin social Facebook.

Nëpërmjet njoftimit, Sindikatave, iu është kërkuar të depozitonin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në adresën: Rruga “Reshit Çollaku”, nr.4 Tiranë, (Zyra e Protokollit), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit dokumentacionin. Publikimi u bë nga data 07.06.2022 deri në datën 17.06.2022.

Pranë Zyrës së Protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare sh.a, rezultoi të ishin depozituar 2 (dy) kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës me Shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, dhe konkretisht nga:

Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1- Kërkesë nr.25 prot., datë 10.6.2022 protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a me nr.1284/3 prot., datë 10.6.2022;
- 2- Vendimin nr.6 datë 02.06.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- 3- Statusi dhe ndryshimet statutores;
- 4- Vërtetimin noterial nr.rep.4535 datë 29.12.2021 “Mbi treguesit e përfaqësueshmërisë”.

Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1- Kërkesë nr.11 prot., datë 16.6.2022 protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a me nr. 1284/4 prot., datë 17.6.2022;
- 2- Vendimin nr.5 datë 22.10.2021 të Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- 3- Statutin e Sindikatës;
- 4- Deklarata anëtarësimi.

Kjo ishte faza fillestare pasi sipas informacionit rezultoi se fazat e tjera janë pezulluar për shkak të kërkesës nr.11500/1 prot., datë 20.06.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si pasojë e ankesës të Sindikatës të Pavarur të Industrisë, Energjitikës dhe Security të Shqipërisë (*Kërkesë e cila i ishte drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*). Në këtë kërkesë kjo Sindikatë kishte kërkuar që çështja e ngritur në ankesë (*kallëzimi penal i ngritur nga kjo Sindikatë*) të trajtohej nga Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a dhe më pas të informohej dhe Asambleja e Përgjithshme.

Sipas informacionit të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a kanë shpjeguar se nëpërmjet komunikimit elektronik me Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, ju është komunikuar se qëndrimi i mbajtur nga Shoqëria Posta Shqiptare sh.a në lidhje me këtë çështje ka qenë korrekt.

Në mbledhje e datës 09.08.2022 të Këshillit Mbikëqyrës së Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a është trajtuar çështja e ankesës dhe Relacioni nr.1826 prot., datë 04.08.2022 i Drejtorisë Juridike, dhe është

vendosur vijimi i procedurave të përzgjedhjes së sindikatës. Për këtë qëndrim u informua dhe Asambleja e Përgjithshme.¹⁰

Më tej u vijua me publikimin, nga data 19.09.2022 deri 03.10.2022, afishime të cilat u bënë në ambientet e Drejtorisë së Filialeve/Degëve dhe Zyrave Postare, ju komunikua të gjithë drejtorëve të Filialeve të Posta Shqiptare sh.a, si dhe u afishuan në vende të dukshme në ambientet e Zyrave Postare.

Kjo ka qenë faza përmbyllëse e procedurës, por për arsye të fillimit të procedimit penal Nr. 5053 datë 01.07.2022, njoftuar më datë 21.10.2022, Grupi i Punës i propozoi administratorit pezullimin përkohësisht të procedurës së nënshkrimit të marrëveshjes kolektive të punës, deri në përfundim të shqyrtimit të kallëzimit penal ngritur nga Sindikata e Pavarur e Industrisë, Energjetikës dhe Security të Shqipërisë.

Vendimmarrja e mësipërme rezultoi që ti jetë komunikuar sipas njoftimit të datës 21.10.2022 Sindikatës së Punonjësve të Posta Shqiptare, gjithashtu rezultoi që ka patur dhe një takim me drejtuesit e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Pezullimi përkohësisht i procedurës së nënshkrimit të marrëveshjes kolektive rezultoi që është kundërshtuar nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare me shkresën nr.37 prot., datë 09.01.2023.

Sipas sqarimeve të dhëna nga Shoqëria Posta Shqiptare sh.a rezultoi se kjo vendimmarrje është kundërshtuar nga të dyja Sindikatat të cilat kanë vënë në lëvizje Zyrën e Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit (*kërkesa nr.45 prot., 2023*). Gjatë seancës të ndërmjetësimit dhe të pajtimit të zhvilluar ndër të tjera u mor vendimi për vijimin e procedurës së përzgjedhjes së Sindikatës më të përfaqësuar duke qenë se procedimi penal i nisur nuk lidhej me çështjen objekt shqyrtimi.

Referuar Procesverbalit të datës 03.03.2023 të Zyrës e Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit është vendosur: *Meqenëse në seancën e pajtimit përfaqësuesit e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a dhanë dakortësinë për vazhdimin e procedurës për lidhjen e kontratës kolektive të punës, në zbatim të nenit 164 të Kodit të Punës, Posta Shqiptare sh.a duhet të shpalli rezultatin sipas provës së përfaqësueshmërisë së paraqitur nga dy sindikatat, me qëllim uljen në bisedime për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës.*

Me shkresën nr. 7656 prot., datë 26.04.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Posta Shqiptare sh.a dhe të dyja Sindikatat pjesëmarrëse në këtë proces u njoftuan mbi Procesverbalin e datës 03.03.2023 e Zyrës së Ndërmjetësimit dhe të Pajtimit.

Grupi i punës i ngritur nga Administratori i Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a për procedurën e përzgjedhjes së fituesit për nënshkrimin e kontratës kolektive të punës evidentoi se Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare, nëpërmjet Vërtetimit Noterial Nr. Rep. 4535, datë 29.12.2021, vërteton se disponon dokumentacionin për 1,470 anëtarë, ndërsa Federata e Sindikatave të

¹⁰ Referuar informacionit të dhënë nga Shoqëria Posta Shqiptare sh.a me shkresënr. 1079/1 prot., date 04.06.2024.

Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, përmes deklaratave të anëtarësimit, vërteton se ka 1,341 anëtarë nënshkrues.

Në këto kushte, grupi i punës konstatoi se numri i anëtarëve i paraqitur nga përfaqësuesit sindikalistë ka mospërputhje. Kjo për arsye se një shoqëri si "Posta Shqiptare" sh.a., e cila ka rreth 2,500 punonjës, paraqet Sindikatën e Punonjësve të Postës Shqiptare (SPPSH), e cila pretendon se ka 1,470 anëtarë, dhe Federatën e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë (FSPTTSH), e cila pretendon se ka 1,341 anëtarë. Kjo rezulton në situatën që një punonjës i shoqërisë së "Postës Shqiptare" sh.a përfaqësohet njëkohësisht në dy sindikata.

Duke u bazuar në Kodin e Punës, rezulton se nuk ka një dispozitë specifike që ndalon pjesëmarrjen e një punëmarrësi në dy sindikata në të njëjtën kohë. Ky kod garanton të drejtat për t'u organizuar dhe për t'u bashkuar me sindikata të ndryshme. Nëse ekziston ndonjë rregullore e brendshme në një ndërmarrje ose marrëveshje kolektive që parashikojnë ndalime ose kufizime mbi pjesëmarrjen në sindikata të ndryshme, ato do të kishin prioritet, por ligji i përgjithshëm nuk vendos një ndalim të tillë.

Punëmarrësit kanë të drejtë të marrin pjesë në një ose dy sindikata njëkohësisht, çka garanton lirinë e organizimit dhe mbrojtjen e interesave të tyre kolektive. Megjithatë, në rastin konkret nga Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, është evidentuar një mospërputhje në numrin e anëtarëve të paraqitur nga sindikatat përkatëse, në total 2811 punonjës, në raport me numrin total të punonjësve, i cili është rreth 2.500.

Në referim të nenit 164, të Kodit të punës, sindikatat kanë barrën e provës për të provuar me shpenzimet e tyre përfaqësueshmërinë dhe vetëm ajo organizatë që provon se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës në ndërmarrje ose degë, vlerësohet si organizata më e përfaqësuar. Mospërputhja e konstatuar e numrit të anëtarëve në total të paraqitura nga dy sindikatat, në raport me numrin total të punonjësve, nuk mundëson vijimin e procedurës, sipas nenin 164, të Kodit të Punës, pasi në bazë të akteve të depozituara nga dy sindikatat nuk mund të arrihet në përfundimin dhe të provohet se cila prej tyre ka përfaqësueshmërinë më të lartë, në kushtet kur numri në total i anëtarëve të të dy sindikatave rezulton më i lartë se pumri i punonjësve pranë punëdhënësit Posta Shqiptare sh.a.

Për të adresuar këtë mospërputhje dhe për të siguruar një proces të qartë dhe të drejtë në lidhjen e kontratës kolektive të punës, me shkresën nr.1160/1 prot., datë 08.06.2023 Grupi i Punës iu ka kërkuar Sindikatave paraqitjen e vërtetimit mbi përfaqësueshmërinë, konform citimit dhe vlerësimit që ka bërë Zyra e Ndërmjetësimit dhe Pajtitimit, duke iu referuar nenit 164 të KP, me qëllim marrjen e një vendimi, por asnjë prej palëve nuk depozitoi asnjë vërtetim, përfshi këtu edhe Sindikatën ankuese pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjendur në këto kushte, Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a. vendosi anulimin e procedurës së përzgjedhjes së Sindikatës me qëllim nënshkrimin e Marrëveshjes Kolektive të Punës pasi asnjë nga Sindikatat nuk përmbushte kriteret ligjore.

Qëndrimi përfundimtar i Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a, i është njoftuar Sindikatës së Punonjësve të Posta Shqiptare me shkresën nr. 2185/1 prot., datë 31.10.2023, duke e informuar për arsyet ligjore të këtij anulimi.

Ky qëndrim rezulton të jetë ankimuar nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare e cila i është drejtuar me shkresën nr.61 prot., datë 06.12.2023 dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Me shkresën nr.2203, datë 22.12.2023 nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i është kthyer përgjigje ku e kanë sqaruar në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë lidhur me procedurën ligjore që Shoqëria Posta Shqiptare sh.a, ka ndjekur për të cilën nuk e kanë gjykuar të padrejtë apo të jenë shprehur për ndonjë shkelje procedurale prej saj, gjithashtu sqarojnë se i kanë rekomanduar kësaj të fundit rihapjen e procedurës së re për lidhjen e kontratës kolektive.

Ndërkohë rezultoi se nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare është vijuar me ankesa të ndryshme si tek Bashkëqeverisja dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Sa më sipër por dhe pas kërkesave të Sindikatës së Punonjësve të Posta Shqiptare, Shoqëria Posta Shqiptare sh.a në bazë të Urdhrit nr.20, datë 07.03.2024 të Administratorit të Shoqërisë është ngritur Grupi i punës për fillimin e një procedure të re për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës.

Grupi i Punës me Relacionin nr.514/1 prot., datë 18.03.2024 i ka propozuar Administratorit të Shoqërisë, publikimin e një njoftimi për pjesëmarrje në Faqen Zyrtare të Posta Shqiptare sh.a në adresën: <http://www.postashqiptare.al/> si dhe në “Posta Shqiptare-Faqja Zyrtare” në rrjetin social Facebook.

Nëpërmjet njoftimit, Sindikatave, iu është kërkuar të depozitonin pranë Drejtorisë së Përgjithshme në adresën: Rruga “Reshit Çollaku”, nr.4 Tiranë, (Zyra e Protokollit), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit dokumentacionin. Publikimi u bë nga data 18.03.2024 deri në datën 31.03.2024.

Pranë Zyrës së Protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Posta Shqiptare sh.a, rezultoi të ishin depozituar 2 (dy) kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës me Shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, dhe konkretisht nga:

1. Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare shoqëruar me:

- Kërkesën nr. 78 prot., datë 28.03.2024, protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a. me nr. 643 prot., datë 28.03.2024;
- Vendimin nr. 6, datë 02.06.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ;
- Statusi dhe ndryshimet statutores;
- Vërtetim noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021 mbi treguesit e përfaqësueshmërisë.

- Vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin nr. rep 2105 datë 25.03.2024 të Vërtetimit noterial nr. rep 4535 datë 29.12.2021.

2. Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, shoqëruar me:

- Kërkesën nr. 702 prot., datë 08.02.2024, protokolluar pranë Posta Shqiptare sh.a. me nr. 296 prot., datë 09.02.2024;
- Vendimin nr. 15, datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Statutin e Sindikatës;
- Vërtetim Noterial datë 07.02.2024 për përfaqësueshmërinë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.

Sa më sipër, në përfundim të vlerësimit të dokumentacionit të mësipërm Grupi i punës ka vlerësuar se nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Posta Shqiptare, është paraqitur një vërtetim noterial, ku noteri ka vërtetuar numrin e anëtarëve të Sindikatës së punëmarrësve, në bazë të kuotizacioneve të paguara për periudhën 01.08.2019-31.07.2021, ndërkohë që neni 164 i Kodit të Punës parashikon përgjatë dy viteve të fundit. Kjo Sindikatë nuk dëshmon dhe provon numrin e anëtarëve punëmarrës pranë Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. Kjo Sindikatë ka paraqitur vërtetim të njehsuar me origjinalin nr.2105 rep., datë 25.03.2024 të Vërtetimit Noterial nr.4535 rep., datë 29.12.2021.

Ndërkohë dokumentacioni i Federatës së Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë është paraqitur konform nenit 163 të Kodit të Punës nga ku vërtetimi noterial, në bazë të kuotizacioneve, parashikon 1.400 punonjës të Shoqërisë Posta shqiptare sh.a anëtarë të kësaj Federate. Pra Federata vlerësohet si organizata me e përfaqësuar duke qenë se provon nëpërmjet vërtetimit noterial, se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës pranë Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.

Në këto kushte Shoqëria Posta Shqiptare sh.a është në fazën e uljes së bisedimeve mbi kushtet e marrëveshjes kolektive me Federatën e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë.

Së pari, në referim të veprimeve të sipërcituara të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a dhe strukturave të saj, Komisioneri më poshtë do të analizojë aktet normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë që trajtojnë dhe rregullojnë procedurën e përzgjedhjes e Sindikatës fituese për lidhjen e Kontratës Kolektive të Punës.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 50 të saj, sanksionon se: *“Të punësuarit kanë të drejtë të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës.”*

Në nenin 51, të saj Kushtetuta, përcakton se: *“1. E drejta e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës, është e garantuar. 2. Kufizime për kategori të veçanta të punësuarish mund të vendosen me ligj për t’i siguruar shoqërisë shërbimet e domosdoshme.”*

Neni 50 garanton të drejtën e punëtorëve për t’u organizuar në sindikata për të mbrojtur interesat e tyre dhe për të ndërmarrë veprime kolektive, përfshirë grevat, në përputhje me ligjin.

Neni 51 garanton të drejtën për të negociuar kolektivisht me punëdhënësit për kushtet e punës dhe të pagave.

Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar:

Neni 176, *“Organizatrat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve”*, përcakton se: *“1. Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata shoqërore të pavarura, që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve, qëllimi i të cilave është përfaqësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomikë, profesionalë dhe shoqërorë të anëtarëve të tyre”.*

Neni 178, *“Fitimi i Personalitetit Juridik”*, parashikon se: *“1. Organizatat sindikale dhe organizatat e punëdhënësve, federatat dhe konfederatat duhet të dorëzojnë aktin e krijimit dhe statutin e tyre në Gjykatën e Tiranës për njohjen e tyre si person juridik.”*

Përsa më sipër, Sindikata e Punonjësve të Posta Shqiptare, mbështetur në dokumentacionin e administruar, ka fituar personalitetin juridik, referuar Vendimit nr.1749, datë 06.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 117 *“Zbritjet nga paga”*, parashikon se: *1. Punëdhënësi zbret nga paga e punëmarrësit tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore, shëndetësore të parashikuara me ligj, me akte nënligjore, me kontrata kolektive ose me kontrata individuale. 2. Punëdhënësi vetëm me autorizim me shkrim nga punëmarrësi mund të zbresë nga paga kuotizacionet sindikale. Ky autorizim mund të shfuqizohet në çdo kohë.*

Neni 159, *“Kontrata Kolektive e Punës”*, parashikon se: *“ Kontrata kolektive përmban dispozita mbi kushtet e punësimit, lidhjen, përmbajtjen dhe përfundimin e kontratave individuale të punës, formimin profesional, si dhe mbi marrëdhëniet midis palëve kontraktuese. 2. Kontrata kolektive mund të përmbajë dispozita që vendosin punëdhënësit dhe punëmarrësit në raporte të detyrueshme të krijuara nga palët me marrëveshje kolektive, ndaj personave juridikë. 3. Kontrata kolektive nuk mund të përmbajë dispozita më pak të favorshme për punëmarrësit se ato të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj.”*

Neni 163 *“Kërkesa për bisedime për lidhjen e kontratës kolektive”*, parashikon se: *1. Çdo organizatë përfaqësuese sindikale, e krijuar në bazë të ligjit, mund t’i kërkojë çdo punëdhënësi ose çdo*

organizate punëdhënësish fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës në nivel ndërmarrjeje, ndërmarrjesh ose degësh aktiviteti, në favor të një ose disa kategorive profesionale. Shumë organizata sindikale mund ta ushtrojnë këtë të drejtë së bashku.

2. Organizatat sindikale kanë të drejtë të kërkojnë informacion mbi të gjitha çështjet që lidhen me bisedimet. Informacioni duhet të jepet brenda 1 jave kalendarike, nga dita që është kërkuar, përveçse kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë ranë dakord për një afat tjetër.

3. Kërkesa për fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive bëhet me shkrim. Ajo shoqërohet me kopjen e statutit të organizatës ose organizatave kërkuuese sindikale, si dhe me treguesit e nevojshëm mbi përfaqësueshmërinë e këtyre të fundit në ndërmarrje, ndërmarrjet ose degën e caktuar.

4. Punëdhënësi, të cilit i është kërkuar fillimi i bisedimeve, duhet ta bëjë kërkesën publike, duke e afishuar, në mënyrë të dukshme, gjatë dy javëve, në ndërmarrje. Nëse kërkesa është bërë në nivel dege, ajo duhet të afishohet në të gjitha ndërmarrjet ose degët. Organizata ose organizatat sindikale, që kërkojnë fillimin e bisedimeve, duhet të kujdesen që afishimi të kryhet në mënyrë të rregullt.

5. Nëse përfaqësueshmëria e organizatës ose e organizatave sindikale, që kërkojnë fillimin e bisedimeve, nuk është kundërshtuar, veprohet sipas nenit 165, të këtij Kodi. Në këtë rast, përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave sindikale nuk mund të kundërshtohet gjatë dy vjetëve.

6. Nëse lidhja e kontratës kolektive nuk është paraprirë nga një afishim i rregullt i kërkesës, punëdhënësit ose organizata e punëdhënësve nuk mund të kundërshtojnë fillimin e një procedure të re të njohjes së përfaqësueshmërisë së organizatës ose organizatave sindikale, me qëllim hapjen e bisedimeve për lidhjen e një kontrate tjetër kolektive. Kontrata e parë kolektive, e lidhur pa respektuar detyrimin e afishimit, është e pavlefshme që nga çasti i hyrjes në fuqi të kontratës së dytë, që është lidhur duke respektuar procedurat e parashikuara në këtë Kod.

7. Përpara miratimit të planeve të punës, që kërkojnë shërbimet e punëmarrësve gjatë natës, punëdhënësi duhet të këshillohet me përfaqësuesit e punëmarrësve të interesuar në lidhje me detajet e këtyre planeve dhe format e organizimit të punës së natës, që janë më të përshtatshme për sipërmarrjen dhe personelin e saj, si dhe për masat për shëndetin në punë dhe shërbimet sociale të nevojshme. Konsultimi duhet të zhvillohet rregullisht në sipërmarrjet ku ka punëmarrës që punojnë gjatë natës.

Neni 164 “Procedura e njohjes së organizatës ose organizatave më të përfaqësuar sindikale”, parashikon se: 1. Nëse përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave sindikale, që kanë kërkuar fillimin e bisedimeve kundërshtohet, çdo organizatë sindikale e interesuar duhet t’i dorëzojë punëdhënësit ose organizatës së punëdhënësve, me shpenzimet e veta, provën e përfaqësueshmërisë. Kjo provë paraqitet në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë.

2. Organizata që provon se ka numrin më të madh të anëtarëve punëmarrës në ndërmarrje ose degë, vlerësohet si organizata më e përfaqësuar. Nëse disa organizata sindikale paraqiten së bashku, vlerësohet më i përfaqësuar grupi i organizatave që ka numrin më të madh të anëtarëve.

3. Nëse punëdhënësi, organizata e punëdhënësve ose organizatat sindikale kundërshtojnë vërtetimin noterial, ata duhet të dorëzojnë një ankim në zyrën e pajtimit të qarkut (nëse bisedimet për kontratën kolektive nuk kalojnë kufijtë e një qarku), ose në Zyrën Kombëtare të Pajtimit (nëse bisedimet për kontratën kolektive shtrihen në më shumë se një qark). Ky ankim duhet dorëzuar brenda dy javëve, duke filluar nga data e shpalljes së rezultatit sipas vërtetimit noterial. Zyra e pajtimit shqyrton të gjitha provat dhe vendos për përfaqësueshmërinë e organizatës ose organizatave sindikale dhe e shpall atë brenda dy javëve nga data e vënies së saj në lëvizje. Kur punëdhënësi ose organizata e punëdhënësve nuk e pranojnë vendimin e zyrës së pajtimit, ata kanë të drejtë të kërkojnë organizimin e një votimi të fshehtë brenda dy javëve nga data e shpalljes së vendimit. Mënyra e organizimit dhe procedura e votimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave sindikale nuk mund të kundërshtohet gjatë dy vjetëve, duke filluar nga data e shpalljes së vendimit nga zyra e pajtimit, të pranuar nga palët, ose të rezultatit nga komisioni i votimit.

Neni 165 “Bisedimet, ndërmjetësimi, arbitrimi” parashikon se: 1. Kur përfaqësueshmëria e organizatës ose organizatave sindikale nuk është kundërshtuar ose kur ajo është njohur në mënyrë përfundimtare, punëdhënësi ose organizata e punëdhënësve duhet të presin palën kërkuese të bisedimeve brenda dy javëve, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të afishimit ose, në rast kundërshtimi të përfaqësueshmërisë, duke filluar nga data e shpalljes përfundimtare të saj. 2. Nëse bisedimet nuk përfundojnë brenda 30 ditëve, duke filluar nga data e përfundimit të afatit të afishimit ose në rast kundërshtimi të përfaqësueshmërisë, duke filluar nga data e shpalljes përfundimtare të saj, asnjëra nga palët nuk mund të përdorë të drejtën e grevës, pa vënë më parë në lëvizje ndërmjetësin, zyrën e pajtimit, si dhe, nëse palët bien dakord, Gjykatën e Arbitrazhit, sipas procedurave të parashikuara në kreun XVII të këtij Kodi.

Neni 166 “Forma” parashikon se: 1. Kontrata kolektive është e vlefshme vetëm në formë të shkruar. Ajo duhet të nënshkruhet nga të gjitha palët. Kur një palë është një organizatë, përfaqësuesit e kësaj të fundit caktohen në përputhje me statutin. 2. Kontrata kolektive mund të zgjidhet ose ndryshohet vetëm me shkrim. 3. Kontrata kolektive është e vlefshme edhe kur bëhet në formën e një vendimi me shkrim të dhënë nga zyra e pajtimit e caktuar me marrëveshje nga palët.

Neni 168 “Ndryshimi dhe ripërtëritja” parashikon se: Në rastet e ndryshimit dhe përsëritjes së kontratës kolektive, zbatohen me analogji dispozitat 164,165 të këtij Kodi.

Neni 172 “Zgjidhja e konflikteve” parashikon se: Gjykata është kompetente për të zgjidhur çdo mosmarrëveshje individuale ose kolektive lidhur me zbatimin e kontratës kolektive.

Neni 175 “Pasojat e zgjidhjes së kontratës kolektive” parashikon se: 1. Kontrata kolektive pushon së ushtruari efektet e saj ndaj palëve kontraktuese, kur përmbushet afati i zgjidhjes së saj. 2. Çdo kontratë individuale pune, e përfshirë në fushën e zbatimit të kontratës kolektive, vazhdon të rregullohet nga dispozitat e kësaj kontrate, me përjashtim të rasteve kur ajo është ndryshuar me marrëveshje midis punëdhënësit dhe punëmarrësit ose kur është zgjidhur prej tyre. I njëjti rregull

zbatohet për marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe çdo personi juridik të parashikuara nga palët në kontratën kolektive. 3. Në kontratën kolektive mund të parashikohet që të gjitha përfitimet që rrjedhin prej saj ose një pjesë e tyre janë të vlefshme gjatë kohëzgjatjes së kontratës. E drejta për të përfutur shuhet në të njëjtën kohë me përfundimin e kontratës.

Neni 188 “Përkufizim”, parashikon se: Me konflikt kolektiv kuptohet çdo konflikt ndërmjet disa punëmarrësish, një ose disa organizata sindikale, nga njëra anë, dhe një ose disa punëdhënësish ose një ose disa organizata punëdhënësish, nga ana tjetër.

Neni 188/a “Ndërmjetësi” parashikon se: Ndërmjetësi caktohet nga ministri përgjegjës për punën ose organi administrativ i autorizuar prej tij brenda administratës publike të ministrisë përgjegjëse për punën.

Neni 189 “Zyra shtetërore e pajtimit” parashikon se: 1. Në çdo qark krijohet zyra e pajtimit. Zyra e pajtimit ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për punën. 2. Zyra Kombëtare e Pajtimit krijohet në Tiranë. 3. Zyra e pajtimit përbëhet nga kryetari dhe 2 anëtarë, përfaqësues të organizatave më të përfaqësuara sindikale dhe 2 anëtarë, përfaqësues të organizatave më të përfaqësuara të punëdhënësve. 4. Kryetari dhe anëtarët paguhen nga shteti në masën e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. 5. Procedura e pajtimit është falas dhe rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 191 “Kompetenca materiale” parashikon se: 1. Ndërmjetësi dhe zyra e pajtimit mund të vihen në lëvizje për çdo konflikt kolektiv. Ata mund të deklarohen jo përgjegjës nëse palët janë të lidhura me një kontratë kolektive në fuqi, e cila parashikon një procedurë pajtimi të mjaftueshme. 2. Konfliktet që lidhen me interpretimin ose zbatimin e ligjit, në parim, shqyrtohen nga gjykata ose Gjykata e Arbitrazhit. Nëse ndërmjetësi ose zyra e pajtimit janë vënë në lëvizje, ata mund të heqin dorë nga procedura e ndërmjetësimit. Çdo palë ruan të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës ose Gjykatës së Arbitrazhit. 3. Kur rrethanat e justifikojnë, kryetari mund të pranojë që zyra e pajtimit të vihet në lëvizje në një konflikt ndërmjet dy a më shumë organizatave sindikale dhe ndërmjet dy a më shumë organizatave punëdhënësish.

Neni 192 “Ndërmjetësi” parashikon se: 1. Ndërmjetësi angazhohet për çdo konflikt kolektiv me kërkesën e çdo pale të interesuar te ministri përgjegjës për punën ose tek Inspektorati Shtetëror i Punës. 2. Ndërmjetësi, kur angazhohet në një konflikt kolektiv, duhet të ndërhyjë pa vonesë për të ndihmuar palët për të gjetur një zgjidhje me mirëkuptim. 3. Procedura e ndërmjetësimit është e detyrueshme dhe zgjat deri në 10 ditë.

Neni 193 “Zyra e pajtimit” parashikon se: 1. Në rast se ndërmjetësi shpall dështimin e ndërmjetësimit, ministri përgjegjës për punën, ose organi administrativ i autorizuar prej tij, vë në lëvizje zyrën e pajtimit. 2. Zyra mund të thërrasë çdo palë të interesuar. Palët kanë detyrimin të paraqiten në seancën e shqyrtimit dhe të marrin pjesë në debate, duke paraqitur të dhënat që kërkon zyra. 3. Me

kërkesën e arsyetuar të njëres prej palëve, vetëm kryetari merr të dhëna për dokumentet e paraqitura nga kjo palë. Më pas ai ua njofton ato, për aq sa e gjykon të arsyeshme, anëtarëve të zyrës së pajtimit. 4. Zyra e pajtimit përpiqet të ndihmojë pajtimin e palëve. 5. Zyra e pajtimit i paraqet palëve një propozim pajtimi, të cilin ajo mund ta bëjë publik vetëm nëse të dyja palët bien dakord për këtë gjë. 6. Palët mund të ndihmohen nga çdo person i caktuar prej tyre. 7. Procedura e pajtimit është e detyrueshme dhe zgjat deri në 10 ditë. 8. Rregullat e tjera procedurale caktohen nga kryetari i zyrës së pajtimit.

Neni 194 “Gjykata e Arbitrazhit” parashikon se: *1. Në rast dështimi të pajtimit, të dyja palët mundën, së bashku, t’i drejtohen Gjykatës së Arbitrazhit. Palët zgjedhin me marrëveshje, në mënyrë të lirë, një ose tre arbitra. Për të ndihmuar dhe këshilluar palët, ministria përgjegjëse për punën u ofron një listë arbitrash. 2. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit është titull ekzekutiv, në bazë të rregullave mbi arbitrimin, të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. 3. Arbitrat paguhen nga palët. 4. Arbitrimi duhet të përfundojë brenda 3 javëve, duke filluar nga data e vënies në lëvizje të Gjykatës së Arbitrazhit*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se marrëdhënia e mëparshme midis Shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a. dhe palës ankuese ka përfunduar, duke rezultuar në mungesën e një lidhjeje juridike, ligjore apo detyruese mes ankuesit dhe institucionit. Si pasojë, për të lidhur një marrëveshje të re për nënshkrimin e kontratës kolektive të punës me këtë shoqëri, kërkohet krijimi i një marrëdhënieje të re, e cila rregullohet nga një procedurë e përcaktuar në kuadër të legjislacionit në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse. Në këtë kontekst, Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a. nuk ka asnjë detyrim ligjor për të lidhur automatikisht kontratën kolektive me këtë sindikatë.

Në këto kushte, në zbatim të legjislacionit të sipërcituar ndryshimi dhe përsëritja e Kontratës Kolektive të Punës, i nënshtrohet dhe ndjek procedura të caktuara, procedurë e cila duhet të përmbajë të drejtat e garantuara nga legjislacioni. Kjo është një kornizë e rëndësishme ligjore për të mbrojtur interesat e punonjësve dhe për të siguruar një marrëdhënie të drejtë dhe transparente ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve.

Kontrata e mëparshme që Sindikata e Punonjësve të Posta Shqiptare ka patur të lidhur me Shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, ka pushuar së ushtruar efektet e saj ndaj palëve kontraktuese, me përmbushjen e afatit të zgjidhjes së saj. Në këto kushte çdo organizatë sindikale përfaqësuese ka të drejtë të kërkojë fillimin e bisedimeve për lidhjen e një kontrate kolektive të punës. Kjo kërkesë bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë statutin e organizatës dhe tregues të përfaqësueshmërisë së saj.

Nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a i është dhënë mundësia për plotësimin e mangësive të konstatuara si dhe i është dhënë koha e nevojshme për rregullimin e tyre, por që asnjëra nga palët në proces nuk ka plotësuar këto mangësi.

Ndërkohë në këtë pikë sqarojmë se nga ana e palëve në proces janë ndjekur të gjitha fazat e ankimit administrativ të parashikuara në dispozitat e mësipërme ligjore. Institucionet hierarkike të Shoqërisë (Këshilli i Mbikëqyrës, Asambleja e Përgjithshme, Zyra e Ndërmjetësimit dhe Pajtimit) kanë vlerësuar se qëndrimi ligjor i Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a si dhe procedura e ndjekur është e drejtë. Ndërkohë pavarësisht të gjithë procedurës së ndjekur nga palët kjo procedurë nuk kishte fitues dhe nuk solli ndonjë pasojë.

Ndërkohë sqarojmë se nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare, nuk janë përdorur të gjitha instrumentet e ankimit pasi legjislacioni parashikon se kundërshtimet dhe mosmarrëveshjet janë kompetencë e gjykatave, hap i cili nuk është ezauruar nga Sindikatat pjesëmarrëse në këtë procedurë.

Ndërkohë në lidhje me procedurën e dytë të shpallur nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare është përjashtuar nga nënshkrimi i marrëveshjes kolektive të punës me Shoqërinë Posta Shqiptare sh.a, për faktin që nuk provon përfaqësueshmërinë e saj me punonjës të Postës. Nga ana e saj është depozituar njësim i kopjes me origjinalin e vërtetimit noterial të vitit 2021 dhe jo tregues mbi përfaqësueshmërinë me numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit.

Sa më sipër, për sa kohë ligji parashikon se çdo organizatë sindikale e interesuar duhet t'i dorëzojë punëdhënësit ose organizatës së punëdhënësve, me shpenzimet e veta, provën e përfaqësueshmërisë, kjo provë paraqitet në formën e një vërtetimi noterial, ku noteri vërteton numrin e anëtarëve të organizatës sindikale, në bazë të kuotizacioneve të paguara gjatë dy vjetëve të fundit (Neni 164/1 i Kodit të Punës) ose deklarimeve, me shkrim ose me gojë, të punëmarrësve anëtarë, atëherë palët në këtë procedurë duhet të plotësojnë këtë kriter.

Në këtë pikë sqarojmë dhe pretendimin e bërë nga Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare, lidhur me interpretimin e këtij neni, duke vlerësuar se bazuar në Vendimin nr.11, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese, është përcaktuar se: *“Zbatimi apo interpretimi i ligjeve është kompetencë e organeve të ngarkuara nga ligji dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, jo vetëm kanë detyrimin, të zbatojnë ligjin por edhe të drejtën ta interpretojnë atë”*.

Në lidhje me pretendimin mbi vërtetësinë e Vërtetimit Noterial të datë 07.02.2024 të paraqitur nga Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe Telekomunikacionit të Shqipërisë, i cili vërteton se 1.400 punonjës të Shoqërisë Posta shqiptare sh.a janë anëtar të kësaj Federate, numër më i madh përfaqësimi në raport me Vërtetimin Noterial të paraqitur nga Sindikata e Punonjësve të Postës Shqiptare, sqarojmë se:

Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", i ndryshuar, përcakton si më poshtë:

- Neni 62 përcakton kompetencat e noterit në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë, ndër të tjera, vërtetimin e dokumenteve.
- Neni 63 përcakton detyrat e noterit, i cili duhet të shpjegojë personave fizikë dhe juridikë se kur këta kryejnë veprime noteriale për të realizuar të drejtat dhe mbrojtjen e interesave të tyre të ligjshme. Ai gjithashtu informon për pasojat juridike që mund të lindin nga kryerja e veprimeve noteriale, me qëllim që të shmangen dëmimet e mundshme të interesave të tyre nga mosdijenja e ligjit. Për më tepër, noteri është i detyruar të hartojë aktet noteriale në mënyrë të qartë dhe të pastër, sipas rregullave të përcaktuara në ligj dhe në rregulloret përkatëse të miratuara nga Dhoma e Noterisë.
- Neni 17 parashikon se regjistrat noterialë, dokumentet dhe arkivat janë të administruara nga noteri dhe janë subjekt i konfidencialitetit dhe fshehtësisë profesionale.

Në përputhje me ligjin, parashikohet një mënyrë e qartë për ankimin ndaj veprimeve të noterëve dhe verifikimin e legjitimitetit të akteve noteriale. Ankesa duhet t'i drejtohet Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat kanë kompetencë ligjore për të ushtruar kontrollin dhe inspektimin e zyrave noteriale.

Parashikimet në Kodin Civil të Shqipërisë:

- Neni 79: Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, i cili ka si synim krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave ose detyrimeve civile.
- Neni 80: Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë, ose në çdo formë tjetër të padyshimtë të shfaqjes së vullnetit. Shkrimi mund të jetë i thjeshtë ose të përfshijë një akt noterial.

Në nenet në vijim, Kodi Civil ka parashikuar gjithashtu mënyrën e provimit të dokumenteve të vërtetuara nga noterët dhe mundësinë e kundërshtimit të tyre në rast se ka dyshime mbi vërtetësinë e akteve noteriale.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se pas shqyrtimit të detajuar të procesit të lidhjes së kontratës kolektive të punës dhe dokumenteve të paraqitura nga palët, është konstatuar se Shoqëria Posta Shqiptare sh.a. ka ndjekur të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji. Anulimi i procedurës së parë dhe përjashtimi nga procedura e dytë kanë ndodhur për shkak të mosplotësimit të kërkesave ligjore nga ana e Sindikatës së Punonjësve të Posta Shqiptare dhe jo për arsye të padrejta apo diskriminuese. Në përputhje me ligjin, Sindikata e Punonjësve të Posta Shqiptare nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm që provon përfaqësueshmërinë e saj, siç kërkohet nga Kodi i Punës. Kjo ka çuar në vendimin për të mos vazhduar me nënshkrimin e marrëveshjes kolektive me Sindikatën.

Sa më sipër, bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, pala ankuese, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Në mungesë të këtij trajtimi, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një diferencë në trajtim apo trajtim të pafavorshëm, nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, për shkaqet e pretenduara nga Sindikata e Punonjësve të Posta Shqiptare dhe për rrjedhojë nuk provohet se Shoqëria Posta Shqiptare sh.a ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11 e 12, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Sindikatës së Punonjësve të Postës Shqiptare, në të drejtën e lidhjes së Kontratës Kolektive të Punës, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe çdo shkak tjetër, nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA